


**BULETINI TREMUJOR**  
FONDI I KURSIMEVE PENSIONALE TË KOSOVËS



**TRUSTORJA**

## PERFORMANCA KUMULATIVE E FKPK-SË PREJ THEMELIMIT



PERIUDHA	1M	3M	1 VIT	3V	5V	NGA THEMELIMI
REZULTATI	+2.29%	+0.33%	-2.15%	+13.41%	+25.27%	<b>+32.14%</b>
BENÇMARKU*	-0.10%	+0.80%	+0.09%	+0.01%	+3.24%	<b>+31.05%</b>

\*INDEKSI I HARMONIZUAR I ÇMIMEVE TË KONSUMIT I PUBLIKUAR NGA AGJENCIA E STATISTIKAVE TË KOSOVËS

## PERFORMANCA DHE KTHIMI NGA INVESTIMET NË TM1 2016

### ÇMIMI I AKSIONIT:

JANAR	▼ -2.19%
SHKURT	▲ +0.28%
MARS	▲ +2.29%
GJITHSEJ PERFORMANCA NETO	▲ <b>+0.33%</b>

### KTHIMI BRUTO:

JANAR	-€26.44 mln
SHKURT	+€3.98 mln
MARS	+€28.67 mln
GJITHSEJ KTHIMI BRUTO	<b>+€6.21 mln</b>

## FAKTET KRYESORE

ÇMIMI I AKSIONIT €1.3214	MJETET NETO NËN MENAXHIM €1,265,333,886.25
PENSIONE TË SHPAGUARA KËTË TREMUJOR €4.82 mln	PENSIONE TË SHPAGUARA KËTË VIT €4.82 mln
LLOGARI TË PENSIONUARA KËTË TREMUJOR 1,168	LLOGARI TË PENSIONUARA KËTË VIT 1,168
LLOGARI TË KONTRIBUESVE 514,813	LLOGARI AKTIVE KËTË VIT 225,740
KONTRIBUES TË RINJ KËTË TREMUJOR 6,850	KONTRIBUTE KËTË TREMUJOR €36.14 mln
SHËRBIME TË OFRUARA KËTË TREMUJOR 23,863	GJITHSEJ LLOGARI TË AKTIVIZUARA NË eTRUSTI 52,371

## PLASMANET DHE PERFORMANCA PËR SECILIN MENAXHUES/EMETUES

MENAXHUESI/EMETUESI	EMRI I FONDIT/INSTRUMENTIT /BANKËS	PLASMANET	PJESËMARRJA	PERFORMANCA
Vanguard	Global Stock Index Fund - Euro	€340,710,899.61	26.92%	-2.29%
BNY Mellon	Global Real Return Fund	€206,448,056.67	16.31%	+2.98%
Schroders	Strategic Bond - Euro Hedged	€9,824,118.60	0.78%	-0.91%
Nordea	1-Stable Return Fund	€184,454,298.27	14.57%	+5.12%
AXA	Global Inflation Linked Bonds	€99,776,769.00	7.88%	+4.12%
Thesari i Republikës së Kosovës	Obligacione dhe fletobligacione	€84,387,267.12	6.67%	+0.67%
KBI	Divident Plus	€64,197,363.62	5.07%	-3.46%
Nordea	1-Global Stable Equity Fund	€78,305,841.05	6.19%	+0.73%
Pictet	High dividend selection Z EUR	€39,868,862.99	3.15%	-1.12%
AXA	WF Optimal Income I EUR	€57,901,625.88	4.57%	-3.12%
BANKA KOMBËTARE TREGTARE	Depozitë me afat	€3,021,762.52	0.24%	+0.30%*
BANKA PËR BIZNES SH.A.	Depozitë me afat	€3,019,232.88	0.24%	+0.27%*
<b>GJITHSEJ</b>		<b>€1,171,916,098.21</b>	<b>92.58%</b>	<b>+0.33%</b>

\*Performanca në këto raste është për çështje ilustrimi dhe nuk lidhet me investimin, pasi janë depozita me afat, me interes të paracaktuar. Norma e paraqitur është për interesin e mbledhur për periudhën fundtetori 2015 deri më 31 mars 2016.

## €6.2 MLN KTHIMI BRUTO PËR TM1

Tremujori i parë 2016 ka filluar me oscilime të mëdha në tregjet financiare, duke bërë që edhe performanca e investimeve të FKPK-së të luhet fort gjatë periudhës. Megjithatë, tremujori u përfundua në territor pozitiv, me kthim bruto prej €6.2 mln, dhe me një rritje modeste të çmimit të aksionit prej +0.33%. Sidoqoftë mjetet nën menaxhim u shtuan për €36 mln, për të shkuar në €1.27 mld, falë kontributeve të reja. Në pesë vjetët e fundit performanca e FKPK-së ka rezultuar me raportin Risk-Shpërblim më të lartë sesa ai i tregjeve të aksioneve. Krahasuar me Vanguard GSEF - ku kjo e fundit përfaqëson mjaft mirë performancën e tregut të aksioneve në përgjithësi - performancat mujore të FKPK-së kanë pasur luhatshmëri (risk) prej 2.8 dhe kthim neto prej 25.3% ndërkaq aksionet luhatshmëri prej 12.6 dhe kthim prej 43.5%. Kështu, për çdo pikë të riskut të ndërmarrë FKPK-ja ka arritur kthim prej 9.0% ndërkaq aksionet vetëm 3.5%. Thënë ndryshe, duke ndërmarrë vetëm 22% të riskut të tregut të aksioneve FKPK-ja ka arritur të sigurojë 58% të kthimit të tregut të aksioneve. Ky raport e bën performancën e FKPK-së gjatë kësaj periudhe mjaft të kënaqshme për Bordin Drejtues, në veçanti kur merret parasysh se: a) mbajtja e riskut të portofolit investues të ulët, dhe b) sigurimi i kthimit sa më të lartë për atë risk të ndërmarrë; janë dy obligimet kryesore ligjor për Bordin për investimin e mjeteve pensionale.

### FAKTORËT ME NDIKIM

Rënia e shpejtë dhe e ndjeshme e çmimit të naftës ka qenë faktori kryesor me ndikim në rënien e vlerës indekseve të bursave anëmbanë botës. Por ndikim negativ kishte edhe pritshmëria e rritjes së normave bazë të interesit në SHBA, si dhe rritja jo e kënaqshme ekonomike në BE. Ndërsa rritja e çmimit të naftës, bashkë me pritshmëritë e rritjes së masave stimuluese fiskale në BE, ishin me ndikim pozitiv në fund të kësaj periudhe.

### PERFORMANCA E FONDEVE INVESTUESE

Nga nëntë fondet që ishin të angazhuara këtë tremujor, katër kishin performancë pozitive dhe pesë negative. Fondi i Nordea SRF (multi-asete); i AXA GILB (instrumente borxhi); i BNY Mellon (multi-asete) dhe fondi i Nordea GSEF (aksione) përfituan nga specifikat e portofolit investues (sipas sektorëve ose instrumenteve) dhe arritën rezultat pozitiv. Ndërsa në territor negativ mbetën fondet e Vanguard GSEF (aksione); Schroders (bono); KBI (aksione); Pictet (aksione), dhe AXA OI (multi-asete), që kryesisht ishin në instrumente të dominuara fort nga aksionet ose bonot jo të mbrojtura nga inflacioni. Vlerësuar në përgjithësi, është mjaft e vështirë të gjenden faktorë të përbashkët që kanë ndikuar në kthimin negativ ose pozitiv këtë periudhë, por duket se fondet investuese me përqendrim më të lartë të investimeve në një instrument të vetëm, dhe me më shumë investime në SHBA ose BE, ishin në disavantazhe nga fondet investuese që nuk i kishin këto tipare.

Investimet në Kosovë ishin me norma të paracaktuara të interesit dhe nuk ndikohen nga faktorë të jashtëm. Interesi i mbledhur për periudhën për investimet në depozita ishte mesatarisht 0.28%, dhe për bono 0.67%. Megjithatë, për shkak të likuiditetit të tepërt të bankave normat e kamatave të ofertuara për fletobligacionet e Qeverisë së Kosovës janë duke rënë ndjeshëm - gjë që e bën investimin e mjeteve në to më të vështirë.

**PERFORMANCA NETO E INVESTIMEVE NË TM1**

**+0.33%**

## PËRFAQËSUES TË FKPK-SË TAKOHEN ME MINISTRIN E FINANCAVE

Anëtarë të Bordit Drejtues dhe Drejtori Menaxhues i FKPK-së janë takuar me Ministrin e Financave të Republikës së Kosovës, z. Avdullah Hoti. Në emër të FKPK-së takimin e udhëhoqi z. Ymer Havolli, Kryesues i Bordit Drejtues, i cili e njoftoi Ministrin Hoti me performancën e investimeve të FKPK-së në vitet e fundit, por edhe me pritshmëritë për vitet në vijim.

Tema kryesore e takimit ishte procesi i ndryshimit dhe plotësimit të Ligjit Nr. 04/L-101, që, sipas Ministrit Hoti, pritet së shpejti të dërgohet në Kuvend për shqyrtim. Ndryshimet pritet të prekin pjesën e investimeve për t'i dhënë FKPK-së fleksibilitet të shtuar dhe përshtatje me zhvillimet në instrumentet globale financiare të dalura në pah nga themelimi i institucionit, por edhe ndryshime që do të mundësojnë avancimin e mëtutjeshëm të institucionit në përgjithësi. Gjithashtu, me këto ndryshime, do të rirregullohen edhe aspekte të funksionimit të Bordit Drejtues dhe komisioneve përkatëse.

Në takim u diskutua edhe për çështjen e ofrimit të tërheqjes në faza nga bankat, angazhimin e përfaqësuesit të Qeverisë së Kosovës në Bord, dhe për nevojën e FKPK-së për zgjerimin e hapësirës së operimit.

## KUVENDI I MIRATOI TARIFAT PËR 2016

Kuvendi i Republikës së Kosovës në seancën e 19 shkurtit i ka miratuar tarifatat menaxhuese të propozuara nga Bordi Drejtues i Fondit të Kursimeve Pensionale të Kosovës për vitin 2016. Gjithsej tarifatat vjetore do të jenë 0.480%, të zbritura nga 0.485% sa ishin deri më këtë datë. Ato përbëhen nga 0.082% tarifë vjetore për operacionet dhe 0.398% për investimet (2015: përkatësisht, 0.085% dhe 0.400%).

Vlen të përmendet se FKPK-ja ngarkon tarifa shumë më të ulëta të menaxhimit sesa fondet e ngjashme në rajon dhe në gjitha vendet anëtare të OECD-së. Kjo ndodh kryesisht për shkak se FKPK-ja është institucion që nuk ngarkon tarifa për të krijuar fitim, sikurse ndodhë në fondet e ngjashme private, por ngarkon tarifa vetëm për koston e investimit të mjeteve dhe për aktivitetin ditor të institucionit (operacionet).

Për rikujtim: Bordi Drejtues i FKPK-së ja ia dërgon çdo vit Kuvendit të Kosovës për miratim tarifatat që do të ngarkohen ndaj mjeteve nën menaxhim për vitin vijues.

## €4.9 MLN TË SHPAGUARA NË TM1

Gjatë TM1 2016 FKPK-ja ka shpague në total €4.9 mln pensione. Nga këto, €4.8 mln i takonin llogarive nga të cilat gjatë kësaj periudhe për herë të parë u tërhoqën kursimet pensionale, kurse €0.1 mln ishin shpagesë e mbetjeve (kontribute që barazohen pas tërheqjes primare).

Këto mjete (€4.8 mln) iu shpërndanë përfituesve të 1,168 llogarive. Prej tyre: 907 ishin të pensionuar të moshës, që tërhoqën sa 82.3% e gjithë shumës së shpague për këtë periudhë; 43 ishin të pensionuar invalidor, që tërhoqën 1.8% të shumës; dhe 218 tërhoqën për rastet e vdekjes, që tërhoqën 15.8% të shumës.

Sa i përket moshës së kontribuuesve, në fund të periudhës moshë mesatare e kontribuuesve aktivë ishte 40.0 vjeç, ndërsa për të gjitha llogaritë 41.3 vjeç. Ndërsa bilanci mesatar i mjeteve të akumuluar nëpër llogari të kontribuuesve në fund të TM1 ishte €2,188 për të gjithë kontribuuesit dhe €3,596 për kontribuuesit aktivë.

## DËRGOHEN PASQYRAT VJETORE

Gjatë TM1 FKPK-ja i ka dërguar për shtypje pasqyrat vjetore të 394 mijë llogarive. Më pas, gjatë marsit, të njëjtat i janë dërguar Postës së Kosovës për shpërndarje. Sipas raportit të dërguar nga Posta e Kosovës realizimi i shpërndarjes është kryer në prill. Përveç dërgimit me Postë, FKPK-ja i ka dërguar edhe rreth 70 mijë pasqyra me e-mail, me çka edhe është ulur kostoja e dërgimit por edhe rritur efikasiteti në shpërndarje.

Përkundër kësaj, në të gjitha rastet kur kontribuuesit nuk e pranojnë pasqyrën vjetore, për arsye të ndryshme, mund ta marrin në çdo kohë në zyrën e FKPK-së në Prishtinë, ose në zyrat e ATK-së në 6 rajonet e vendit.

## INVESTIMET NË KOSOVË MBI €90 MLN

Investimet e FKPK-së në Kosovë ishin mbi €90 mln në fund të TM1, nga €95.7 mln që ishin në fund të tremujorit paraprak. Kuptohet se vlera e investimeve në Kosovë ndryshon gjatë vitit sipas kohës kur maturaon dhe/ose investohen mjete shtesë.

Nga këto €90 mln rreth €84 mln ishin investimet në letrat me vlerë të Thesarit të Kosovës, dhe rreth €6 mln në depozita afatshkurtra në dy banka komerciale.

## U PËRFUNDUA RAPORTI VJETOR 2015

FKPK-ja e ka përfunduar përpilimin e Raportit Vjetor dhe Pasqyrave Financiare për vitin 2015 në tri gjuhë: shqip, serbisht dhe anglisht. Raporti vjetor është publikimi më i rëndësishëm i institucionit dhe përmbledh të dhënave dhe ngjarjet më të rëndësishme të vitit. Raportet vjetore mund të gjenden *online* në vegzën vijuese: <http://trusti.org/sq/per-ne/reports-alb/raportet-vjetore/>

Me shumë rëndësi të thuhet se edhe këtë vit auditori i jashtëm ka dhënë opinion të pastër për pasqyrat financiare të FKPK-së, duke vlerësuar se: "Sipas opinionit tonë, pasqyrat financiare paraqesin në mënyrë të drejtë, në të gjitha aspektet materiale, pozicionin financiar të Fondit të Kursimeve Pensionale të Kosovës më 31 dhjetor 2015, si dhe performancën financiare dhe rrjedhën e parasë për vitin që ka përfunduar në këtë datë, në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar".

## 52,371 LLOGARI NË eTRUSTI

Numri i kontribuuesve që kanë aktivizuar llogari në shërbimin e bazuar në internet, eTrusti, arriti në fund të kësaj periudhe në 52,371 (TM4 2015: 48,427), që paraqet një rritje prej 8% me tremujorin paraprak.

Rritja më e fortë e numrit të kërkesave për hapje të llogarisë në eTrusti në tremujorin e parë të vitit është e zakonshme, për shkak se gjatë kësaj periudhe shpërndahen pasqyrat vjetore të llogarive, duke nxitur kontribuuesit të interesohen më shumë për kursimet pensionale.

## 23,863 SHËRBIME NË TM1

FKPK-ja i ka ofruar në zyrën e saj 23,863 shërbime gjatë TM1, ose 28% më shumë se tremujori paraprak (TM4 2015: 18,680). Po ashtu kontribuuesit morën edhe 11,934 shërbime nëpër zyrat rajonale të ATK-së, dhe i kryen 2,988 vetëshërbime në eTrusti. Nga totali i shërbimeve, 53.2% ishin rastet e shtypjes së pasqyrës së llogarisë, duke qenë shërbimi dukshëm më i preferuar. Më pas ishte autorizimi i qasjes në eTrusti (12.2%) dhe njoftimi për pensionim (8.9%).

### **BOTUES:**

Fondi i Kursimeve Pensionale të Kosovës  
Maj 2016

### **REDAKTOR:**

Vërshim Hatipi

### **AUTOR:**

Jeton Demi

### **KONTAKT:**

Rr. "Agim Ramadani" Nr. 10,  
10000 Prishtinë

038-244-341

info@trusti.org  
www.trusti.org